



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1235/3 Prot.

Tiranë, më 16 / 09 / 2019

**V E N D I M**

**Nr. 122 , Datë 16 / 09 / 2019**

Mbështetur në Ligjin Nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 107, datë 06.09.2019, e R.B, i mbështetur nga Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në të cilën pretendohet diskriminim, por pa përcaktuar një shkak të mbrojtur<sup>1</sup>. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga R.B, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në informacionin e dhënë nga ankuesi me shkresën nr. 31/1, datë 06.08.2019, në mes të tjerash informohet se: *“R.B ka qenë punonjës policie me gradën “Inspektor”. Me Urdhrin nr. 1146/5, datë 09.10.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është përjashtuar nga policia e shtetit, për shkelje të rëndë disiplinore “Përdorimi i pijeve alkolike gjatë punës/shërbimit dhe në rastet kur është me uniformë”. Përjashtimin nga policia e shtetit, R.B e ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me Vendimin nr. 3896, datë 01.11.2018 ka vendosur shfuqizimin e vendimit të Drejtorit të Policisë së Shtetit për “Përjashtimin nga policia” të R.B, dhe detyrimin për dëmshpërblim të paditësit. Pas marrjes së vendimit të gjykatës, R.B me anë të disa shkresave i është drejtuar Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë në të cilat ka*

---

<sup>1</sup> Me e-mail-in datë 09.08.2019 nga ana e zyrës së Komisionerit, është kërkuar nga ankuesi shkak i diskriminimit të pretenduar. Në datë 06.09.2019 pranë zyrës së Komisionerit është paraqitur subjekti ankues i cili lidhur me shkakun e diskriminimit, ka deklaruar se: *“E akuzojnë se gjatë detyrës ka konsumuar pije alkolike, ndërkohë që ka konsumuar pije vetëm në festa familjare”.*

*kërkuar rikthimin në strukturat e Policisë së Shtetit. Në përgjigje të kërkesave të ankuesit të gjitha institucionet janë përgjigjur se vendimi i gjykatës nuk ka vendosur për rikthimin e tij në Policinë e Shtetit, por ka vendosur për pagimin e dëmshpërblimit. Ankuesi shprehet se moskthimi në punë pa arsye objektive dhe ligjore e ka dëmtuar financiarisht dhe diskriminuar publikisht si punonjës policie”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin në punë.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur. Ankuesi në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, lidhur me shkakun e diskriminimit.

Neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh. Në rastin konkret, ankuesi duhet të identifikojë një cilësi apo karakteristikë personale për të cilën pretendon se është trajtuar në mënyrë të pafavorshme. Në rastin konkret ankuesi ka vënë në

dispozicion, bashkëngjitur formularit të ankesës fakte dhe prova lidhur me korrespondencën që ka pasur me institucionet e policisë së shtetit për rikthimin e tij në punë, por nuk ka vënë në dispozicion asnjë provë, fakt apo argument lidhur me identifikimin e një cilësie apo karakteristike personale për të cilën pretendon se është trajtuar në mënyrë të pafavorshme në raport me punonjësit e tjerë. Ankuesi duhet të identifikojë një cilësi apo karakteristike personale për të cilën pretendon se është trajtuar në mënyrë të pafavorshme.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, R.B mund të jetë vënë përpara veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, por në bazë të rrethanave të shpjeguara nga ankuesi, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetimi”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a/b, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së R.B, për shkak se është haptazi e pabazuar, për të bërë të mundur një hetim, sipas parashikimit të dispozitave të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

**ROBERT GAJDA**

**KOMISIONER**